



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

**Plani strategjik i veprimeve**

2023-2025

Prishtinë, Janar 2023

## Tabela e përmbajtjes

1. Procesi i hartimit të Planit Strategjik -FIM 2023-2025 .....	1
2. Misioni i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.....	2
3. Struktura organizative e FIM-it.....	3
4. Plani Strategjik për FIM-in.....	4
5. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi .....	7
6. Plani i Veprimit për Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike .....	8
6.1 Mësimdhënia dhe mësimnxënia.....	8
6.2 Puna kërkimore shkencore/artistike .....	11
6.3 Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi.....	13
6.4 Niveli i studimeve dhe programet e kërkuara nga tregu .....	23
6.5 Zhvillimi i burimeve njerëzore.....	29
6.6 Zhvillimi i sistemit të IT-së .....	32
6.7 Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave.....	33
6.8 Zhvillimi i infrastrukturës .....	35
6.9 Globalizimi/ndërkombëtarizimi .....	37

## **1. Procesi i hartimit të Planit Strategjik -FIM 2023-2025**

Në bazë të nenit 72 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, mori Vendim për emërimin e grupit punues për hartimin e Planit të Veprimeve për FIM-ë, më qëllim të zbatimit të planit strategjik të UP-së.

Grupi Punues në fokus do të ketë planin strategjik të UP-së 2020-2022. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të FIM-it do të udhëhiqen nga ky dokument i cili njëkohësisht do të jetë edhe tregues i performancës së strukturave menaxhuese të FIM-it mbi bazën e monitorimit dhe rishikimit vjetor të tij.

Grupi Punues i ngushtë ka mbajtur disa takime pune dhe konsultative në të cilat ka përcaktuar shtyllat me prioritetet për zhvillim të FIM-it dhe ka punuar një draft inicial i cili është dërguar për kontribute shtesë menaxhmentit të Fakultetit, me qëllim të kontributit të tyre dhe duke marrë për bazë të gjitha përgjegjësitë që nxjerr dokumenti për punën e tyre.

Anëtarët e grupit punues:

Prof. Dr. Ilir Doçi

Prof.asoc.dr. Afrim Gjelaç

Prof.asoc.dr. Xhevahir Bajrami

Prof.dr. Hysni Osmani

Prof.dr. Shaban Buza

Prof.dr. Arbnor Pajaziti

Prof.asoc.dr. Ramadan Mazrekaj

Prof.ass.dr. Arlinda Rrecaj

Prof.ass.dr. Shkelzen Shabani

Prof.ass.dr. Drilon Meha

Fatmire Kuçi, Sekretarja

## **2. Misioni i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike**

Misioni i FIM-it buron nga misioni themelor i Universitetit të Prishtinës (Neni 6 i Statutit të Universitetit të Prishtinës, 2012, si institucion publik autonom i arsimit të lartë, që zhvillon arsimim akademik, kërkime shkencore, krijime artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike). Bazuar në këtë, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka definuar misionin e tij në shkollimin e të rinjve në fushën e Inxhinierisë Mekanike, në të gjitha nivelet e arsimit të lartë, me qëllim që të jenë në gjendje t'i përgjigjen kërkesave të tregut të punës në vend dhe më gjerë, t'i përshtaten edukimit të vazhdueshëm në këtë fushë, si dhe të kontribuojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm teknologjik, social dhe shkencor të Kosovës.

FIM si njësi akademike e UP-së është e përkushtuar që të integrohet në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Hapësirën Evropiane të Kërkimeve Shkencore (ERA). Ky është përkushtim dhe orientim strategjik i deklaruar në dokumentet e miratuara që kanë të bëjnë me arsimin e lartë në nivel kombëtar, në nivel të universitetit dhe gjithashtu në nivel të fakultetit (Ligji Mbi Arsimin e Lartë, Statuti i UP-së, Rregullorja për studime bachelor, master dhe të doktoratës në FIM etj.).

### 3. Struktura organizative e FIM-it

Struktura organizative e FIM-it është paraqitur në organogramin në vijim, ku mund të shihen ndërlidhjet në mes të stafit menaxhues dhe njërive të ndryshme shërbyese që funksionojnë brenda fakultetit.




Figura 1. Struktura organizative e FIM

## 4. Plani Strategjik për FIM-in

Plani strategjik përmban në vete tetë fusha të veçanta strategjike, ku përfshihen edhe iniciativat strategjike përkatës, të cilat UP-ja duhet të përqendrohet t'i implementojë gjatë periudhës kohore 2023 – 2025. Në vijim, në formë të përmbledhur, janë paraqitur iniciativat e veçanta të parapara për implementim:

**Mësimdhënia dhe mësim-nxënia** – ka si synim të përmirësojë mësimdhënien (metodologjitë e reja, përmirësimi i pedagogjisë së mësimdhënësve, ngritja e kapaciteteve, etj.), kërkimet shkencore (rritja e numrit të publikimeve shkencore në revista konkurruese, pjesëmarrja në konferenca, hulumtime në laboratorë, bashkëpunim me Universitetet partnere, bashkëpunim në projekte ndërkombëtare etj.), mbështetja e zhvillimit profesional të stafit, dhe shërbimin (siç është shërbimi ndaj komunitetit), bashkëpunimin me ekonominë, hartimi i teksteve mësimore, ngritja e performancës akademike, avancimi i punës me studentet, përmirësimi i kurrikulave mësimore, përvetësimi i teknologjive të reja në fushat e programeve të FIM etj. Programet e FIM-it janë në harmoni me deklaratën e misionit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që të përgatisë të diplomuarit në fushën përkatëse të studimit (formimi profesional). Synimi ynë i vazhdueshëm është: (1) Përmirësimi i mësimdhënies- duke përdorë metodat më të avancuara të mësimdhënies, (2) Rekrutimi i personelit të ri si dhe rritja e kompetencave si rezultat i aplikimit të metodave mësim gjatë gjithë jetës (mbështetja e zhvillimit profesional të stafit), (3) Ngritja e performancës akademike dhe hulumtuese e stafit mësimdhënës duke u bazuar në metodat më të reja të kërkimeve shkencore, duke organizuar punëtori trajnuese për mësimdhënës dhe publikime në revista me recension ndërkombëtarë.

Më tutje, studentët do të përgatiten: (1) Të identifikojnë, formulojnë dhe zgjedhin probleme komplekse inxhinierike duke zbatuar parimet e inxhinierisë, shkencës dhe hulumtimit (2) Të komunikojnë në mënyrë efektive dhe me kompetencë, (3) Të hulumtojnë në mënyrë efektive në ekip, të cilët krijojnë një mjedis bashkëpunues dhe gjithëpërfshirës, vendosin qëllime, planifikojnë detyra për përmbushje të objektivave.

**Puna kërkimore shkencore/artistike** – ka të bëjë me rritjen e rezultateve kërkimore–shkencore të stafit akademik të FIM-it në revista me recension të pranuar në nivel ndërkombëtarë në fushat përkatëse të studimeve dhe hulumtimeve. Më tutje, synimi është që të sigurohet përkrahja e stafit në zhvillimin profesional dhe mbështetja në metodologjinë e hulumtimeve, analiza statistikore, shkrimit për revista, doracakë, libra, kapituj librash, sipas mundësive, mbulimi i kostos së publikimit. Po ashtu përfshihet edhe puna hulumtuese në laboratorë. Për më shumë, kjo do të mundësoj rritje të mundësive për realizimin e punëve dhe shërbimeve, që janë burim i të hyrave të fakultetit dhe universitetit, si dhe krijimi i kushteve për aktivitete shkencore në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare.

**Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi** - Nënkuptojnë proceset të cilat ndërmerren në kuadër të njësive akademike për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për të arritur rezultate më të mira. Nëpërmjet sigurimit të cilësisë synohet rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe transferit të dijes nga stafi akademik, evidentimi i progresit të studentëve, avancimi i përmbajtjes së lëndëve si dhe ngritja e vetëdijes së studentëve për vlerësim real të lëndëve. Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe integrim në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, në kuadër të procesit të akreditimit synohet zhvillimi i programeve master dhe të doktoratës, duke përfshirë disa module në gjuhën angleze në përputhje me sistemin e Bolonjës. Ky proces do të kontribuoj në rritjen dhe përmirësimin e rezultateve shkencore dhe

kërkimore në FIM. Gjithashtu në kuadër të akreditimit është e domosdoshme që programet studimore të FIM-it të jenë të përshtatura me nevojat e tregut të punës.

**Niveli i studimeve dhe programet e kërkua nga tregu i punës** - Zbatimi i programeve në pajtim me nevojat e tregut të punës; Arritja e rezultateve të matshme të programeve studimore; Rritja e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat për t'i lidhur programet me kërkesën, aftësitë aktuale dhe kërkesat e njohurive dhe nevojat e ardhshme;

**Zhvillimi i burimeve njerëzore** - Zhvillimi dhe zgjerimi i organogramit të personelit dhe strukturave të ardhshme të stafit; Trajnimi në vazhdimësi i stafit administrativ dhe laborantëve; Qartësimi i detyrave të punës dhe përgjegjësi për stafin administrativ.

**Zhvillimi i sistemit të TI-së** - Implementimi i sistemit informativ globalisht konkurrues; Zhvillimi i shërbimeve studentore me standardet e BE-së/SHBA-së; Inicimi i sistemit të zhvillimit të studentëve për të mësuarit në tërësi; Fuqizimi i rrjetit *alumni*;

**Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave** - Hartimi dhe zbatimi i financave dhe sistemeve buxhetore (politikat, softuerë, proceset, trajnimi dhe shfrytëzimi) për përmirësimin e menaxhimit të universitetit dhe përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe raportimet e ndërsjella për realizimin e objektivave dhe iniciativave strategjike.

**Zhvillimi i infrastrukturës** - Zhvillimi i mëtejme i laboratorëve të FIM; Shtimi i pajisjeve didaktike, shtimi i sallave mësimore kompjuterike, shtimi i softuerëve hulumtues mësimor. Zhvillimi i strategjisë për menaxhimin e burimeve të kampusit; Mundësia e zhvillimit të infrastrukturës për aktivitete në kampusin e fakultetit;

**Globalizimi/ndërkombëtarizimi** - Zbatimi i programeve/niveleve studimore në gjuhën angleze me partnerët ndërkombëtarë; Rritja dhe funksionalizimi i partneriteteve si motra; Rritja e numrit të aplikimeve për mobilitet dhe bursa; Përkrahja e stafit për projekte të përbashkëta për marrjen e fondeve ndërkombëtare; Përshkrimi dhe verifikimi i transkripteve dhe dokumenteve (sipas kërkesës së partnerëve ndërkombëtarë); Rritja e bashkëpunimit me komunitetin ndërkombëtar jo universitar apo korporatat private.

Ky plan strategjik është paraparë të implementohet nga të gjitha strukturat apo zyrat e UP-FIM-it , ku përfshihen zyra e dekanit, zyrat e ndryshme në nivel të fakultetit (p.sh. zyra për zhvillim akademik, zyra e TI-së, zyra për shërbim të studentëve, biblioteka, etj.), si dhe në një masë të madhe vetë departamenteve të fakultetit.

Në total, numri i detyrave/aktiviteteve të parapara në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike për të gjitha iniciativat strategjike janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Në kuadër të kësaj, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (FIM) në UP është formuar një komision i përbërë prej 11 anëtarëve që i përkasin stafit akademik të fakultetit në fjalë, të cilët kanë mbajtur një seri të mbledhjeve dhe kanë hartuar planin e veprimit, ku përfshihen aktivitetet specifike që duhet të ndërmarr FIM për të realizuar objektivat e parapara në kuadër të strategjisë në fjalë. Në formë të përmbledhur, plani i veprimeve i hartuar për FIM përfshin aktivitetet e dhëna, të cilat duhet të realizohen në periudhën kohore 2023-2025.

Plani konkret i veprimit i hartuar në këtë dokument do t'i shërbej zyrës së dekanit si kornizë mbështetëse për realizimin e strategjisë UP-së për sa i përket fakultetit në fjalë. Zyra e Dekanit (ku përfshihen prodekanët) në bashkëpunim të ngushtë me shefat e departamenteve do të jenë të angazhuar drejtpërdrejt në zbatimin e këtij plani të veprimit, përderisa Këshilli Drejtues i Universitetit dhe Zyra e

Rektorit do të jenë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e kryerjes së veprimeve specifike të parapara në bazë të raporteve të përpiluara nga fakulteti në fjalë.

Në vijim, në formë të detajuar, janë paraqitur aktivitetet e veçanta që do të zhvilloj FIM për arritjen e objektivave të parapara me planin strategjik të UP-së, të cilat janë në kompetencën e fakultetit në fjalë. Secili aktivitet i paraparë ka të përcaktuar periudhën e realizimit të tij, si dhe stafin përgjegjës për realizim.



## **5. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi**

Monitorimi dhe vlerësimi janë faktorë themelorë të zbatimit të një strategjie dhe synojnë matjen e progresit të arritur. Këshilli i FIM emëron një komision për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të kësaj strategjie, sipas dinamikës së paraparë për Planin e Veprimit. Komisioni për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të strategjisë, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat relevante të FIM-it, do të monitorojë rregullisht zbatimin e Planit të Veprimit të kësaj strategjie dhe në etapa të caktuara të raportojë. Këshilli i FIM do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e kësaj strategjie.

Të dhënat që zyrat përkatëse do të dorëzojnë në komision për monitorim dhe vlerësim duhet të përfshijnë: aktivitetet e realizuara dhe progresin, efektet, ndikimet, vështirësitë, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet.

Zyrtarët përgjegjës do të marrin të dhëna edhe nga donatorët. Për të siguruar monitorimin e duhur të Planit të Veprimit janë përcaktuar treguesit për monitorimin e zbatimit të strategjisë. Këta tregues do të mundësojnë monitorimin e progresit, duke vënë në dukje nivelin e arritjes së objektivave dhe realizimin e qëllimeve të kësaj strategjie. Kjo strategji është një dokument aktiv dhe do të rishikohet e do të plotësohet në baza vjetore.

Monitorimi dhe vlerësimi i qëndrueshëm i kësaj strategjie përmes Planit të Veprimit iu siguron zbatuesve të saj një pasqyrë, e cila ua mundëson të veprojnë me kohë dhe në përputhje me nevojat dhe sfidat, me të cilat përballet aktualisht sektori i arsimit të lartë, por edhe në të ardhmen. Plani i Veprimit i kësaj strategjie është ndërtuar në një strukturë tabelare, progresi i të cilit do të monitorohet rregullisht në takimet e rregullta të udhëhequra nga Komisioni për Monitorim dhe Vlerësim.

Në fund të zbatimit të strategjisë do të bëhet një vlerësim i përgjithshëm për të kontrolluar deri në çfarë mase kjo strategji ka ndikuar në fuqizimin e FIM, duke i konsideruar si bazë Strategjinë e UP-së.

## 6. Plani i Veprimit për Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike

Në vijim janë paraqitur detyrat dhe aktivitetet e parapara në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të cilat kanë për synim arritjen e objektivave të veçanta të parapara nga plani strategjik i Universitetit të Prishtinës. Secila prej detyrave është e shoqëruara me detajet përcjellëse për indikatorët (matësit) që tregojnë realizimin e detyrave të caktuara, afatin kohor, stafin apo njësinë/departamentin përkatës që është përgjegjës për kryerjen e detyrave, si dhe koston përkatëse të paraparë të shpenzimeve.

6.1 Mësimdhënia dhe mësimnxënia						
Objektivat strategjike: (a) Përmirësimi i udhëzimeve bazuar në metodologjitë dhe kërkesat e kohës (b) Shërbime për komunitetin (c) Ngritje e performancës akademike						
Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat dhe aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi përgjegjës	Burimet/kostojat (€)
Përmirësimi i udhëzimeve bazuar në metodologjitë dhe kërkesat e kohës	Ofrimi i mundësive për lehtësi të nxënies së njohurive nga studentët dhe krahasueshmëria me rezultatet e arritura	-Avancimi dhe qasja elektronike në SEMS për studentët, përfshirë të gjitha informatat e nevojshme për lëndët, notat, aktivitetet dhe të dhënat e studentëve (kurset), rezultatet, Course Sites, Moodle, etj. -Evidentimi i ngecjeve në mësimdhënie dhe trajnimet e rregullta apo edhe ad hoc për mësimdhënësit. -Përmbushja e kushteve dhe standardeve të detajuara -Përmirësimi apo përsosmëria e programeve të studimeve konform kërkesave të parashtruara nga informatat kthyesë nga nevojat e tregut të punës -Organizimi i punëtorive mujore gjatë kohës së pauzës (12:00-13:00) në lidhje me praktikat më të	-Të gjithë studentët të pajisen me e-mail zyrtar dhe kartelë zyrtare të studentit. -Të vendoset i gjithë materiali mësimor në SEMS dhe platformat tjera të specializuara për mësimdhënie interaktive. - Avancim i modulit <i>e-student</i> në platformën SEMS. - Avancim i modulit <i>e-stafi</i> akademik në platformën SEMS. - Avancim i modulit <i>e-stafi administrativ</i> në platformën SEMS.	Janar 2023 - proces i vazhdueshëm	-Dekani, -Prodekani për mësim dhe çështje të studentëve -Shefat e departamenteve -Koordinatori për zhvillim akademik -Zyrtari i IT-së së FIM-it .	5000

		<p>mira të mësimdhënies (6 herë në vit akademik)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Krijim i modulit për komunikim me studentë brenda SEMS-it</li> <li>-Krijim i modulit për dorëzimin dhe vlerësimin e seminareve dhe projekteve të studentëve në SEMS</li> <li>-Të bëhet organizimi i ueb faqes së FIM-it në atë formë, ku secili mësimdhënës të jetë përgjegjës për organizimin e ueb faqes së lëndës për të cilën është përgjegjës</li> <li>-Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit i studenteve nëpërmjet angazhimit në punë ekipore dhe individuale nëpërmjet aplikimit të aplikacionit adekuat për monitorim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Numri i stafit të trajnuar</li> <li>- Niveli i trajnimit</li> <li>- Rishikimi i syllabuseve në secilin program të studimit dhe adaptimi i programeve studimore;</li> <li>- Programet studimore të akredituara</li> <li>- Vendosja e platformave shkencore dhe shërbimeve tjera për studentë dhe stafin (p.sh. science direct, web of science, Moodle, Turnitin, etj.)</li> </ul>			
			<ul style="list-style-type: none"> <li>-Stafi realizon shpalljen e rezultateve dhe njoftimeve ne ueb faqen e lëndës përkatëse duke respektuar rregulloret në fuqi</li> </ul>	Prill 2023-proces i vazhdueshëm	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Dekani,</li> <li>-Prodekani për mësim dhe me studentë</li> <li>-Zyrtari i TI-së</li> <li>-Zyrtarja për mësim</li> </ul>	15,000
Shërbime për komunitetin	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Të vendosen standarde për trupin pedagogjik, që veprojnë si anëtarë të trupit pedagogjik të UP-së për shërbim në</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Të zhvillohet një skeme “shpërblimi” për shërbim në komunitet si kusht për punësim, avancim, etj.;</li> <li>-Të zhvillohet një sistem i politikave për shërbim në komunitet;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Të matet progresi në drejtim të qëllimit.</li> <li>-Draftimi i procedurave</li> <li>-Numri i shërbimeve të</li> </ul>	Tetor 2023-proces i vazhdueshëm	Dekanati Departamentet Stafi akademik	3,000

<p>UP dhe komunitetin në Kosovë dhe më larg.</p> <p>-Gatishmëria dhe përvoja e UP-së për të ofruar dije dhe shërbime sipas kërkesave të komunitetit.</p>	<p>-Të zhvillohet një protokoll për projekte për të mirën e përgjithshme në FIM, UP dhe në komunitet.</p> <p>-Promovimi i mundësive të FIM-it nëpër shkolla të mesme</p> <p>-Aktivizimi i instituteve në kuadër të FIM-it , për hulumtime dhe realizimin e ekspertizave profesionale për nevojat e komunitetit</p> <p>-Ndarja e detyrave javore, mujore ose vjetore për stafin. P.sh. Disajnimi dhe mbledhja e të dhënave për Business Karta, Krijimi dhe mirëmbajtja e faqeve zyrtare në rrjeta sociale</p> <p>-Pjesëmarrje në organizimin e takimeve nëpër shkolla të mesme.</p>	<p>ofruara në komunitet</p> <p>-Numri promovimeve të realizuara</p> <p>- Numri i ekspertizave të realizuara</p> <p>-Numri i postimeve të realizuara</p> <p>- Numri i ndjekësve në rrjetat sociale</p> <p>-Numri i videove promovuese të realizuara</p>			
		<p>-Promovimi i mundësive të FIM-it nëpër shkolla të mesme</p>	<p>Mars 2023- proces i vazhdueshëm</p>	<p>Dekanati Stafi akademik</p>	<p>3,000</p>
		<p>-Menaxhimi i Institutit në kuadër të FIM-it , për hulumtime dhe realizimin e ekspertizave, projekteve profesionale, për nevojat e komunitetit</p>	<p>Janar 2023 - proces i vazhdueshëm</p>	<p>Drejtori dhe sekretari i Institutit të FIM-it.</p>	<p>6,120</p>
		<p>-Ndarja e detyrave javore, mujore ose vjetore për stafin.</p> <p>-Krijimi dhe mirëmbajtja e faqeve zyrtare në rrjeta sociale.</p>	<p>Janar 2023- proces i vazhdueshëm</p>	<p>-Dekani -Stafi akademik - zyrtari i TI-së.</p>	

Ngritje e performancës akademike	Vlerësimi i performancës së studentëve bazuar në sistemin e Bolonjës	-Dizajnimi i procesit të vlerësimit të performancës së studentëve bazuar në sistemin e Bolonjës; - Të mundësohet zhvillimi i mësimit, konsultimeve dhe provimeve përmes veglave softuerike online -Të zhvillohet moduli në SEMS për rezervimin paraprak të sallave për provime dhe takime	- Sistemi për përcjelljen implementuar për performancën e studentëve në vend; - SEMS-i përfshinë orarin e mësimit, konsultimeve dhe provimeve. - SEMS-i ofron mundësinë e rezervimit të sallave për provime dhe takime	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	-Dekani, Prodekani për mësim dhe çështje të studentëve, Këshilli i Fakultetit, -Zyrtari i IT-së	
----------------------------------	--	---	--	---------------------------------	--	--

## 6.2 Puna kërkimore shkencore/artistike

Objektivat strategjike:

- (a) Përmirësimi dhe rritja e rezultateve në FIM
- (b) Inovacioni gjatë punës kërkimore/shkencore/artistike

Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat dhe aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi përgjegjës	Burimet/kostoja (€)
Përmirësimi dhe rritja e rezultateve në FIM	Inkurajimi i përfshirjes së kapaciteteve ndërkombëtare në kërkime shkencore, si dhe përmirësimi i bashkëpunimeve tjera ndërkombëtare	-Raportimi në baza vjetore për rezultatet e arritura dhe masat obligative të ndërmarra -Krijimi i grupeve kërkimore shkencore në kuadër të FIM-it - Mbajtja e seminarit shkencorë në baza vjetore me shkencëtarë ndërkombëtarë, nga diaspora dhe vendorë	-Numri i punimeve të publikuara -Numri i konferencave -Numri i grupeve kërkimore shkencore të themeluar	Janar 2023 - Dhjetor 2025	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim me ekonomi	0.07% e buxhetit vjetor të UP-së

		<ul style="list-style-type: none"> <li>-Hulumtimi i mundësive që punimet e prezantuar në seminar të publikohen në ndonjë revistë shkencore me recension ndërkombëtarë në formë të ndonjë edicioni special (special edition)</li> <li>-Gjetja e mundësive për sjelljen e konferencave shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare.</li> <li>-Gjetja e mundësive për pjesëmarrje ne projekte shkencore vendore dhe ndërkombëtare (thirrjet për projekte nga UP, MASHTI, FULBRIGHT, HORIZON EUROPE, ERASMUS+, CEEPUS, HERAS, EPA, DAAD, GIZ, ADA, subjekte të ndryshme financuese, etj.)</li> <li>-Aplikimi për mobilitetet qe ofrohen nga institucionet (MASHTI, FULBRIGHT, HORIZON EUROPE, ERASMUS+, CEEPUS, HERAS, EPA, DAAD, GIZ, ADA, subjekte të ndryshme financuese, etj.).</li> <li>-Të krijohet baza e shënime e publikimeve shkencore të stafit akademik të FIM-it , ku secili mësimdhënës duhet t'i regjistroj publikimet e tij të cilat pranoen në të pas verifikimit</li> <li>- Të krijohet hapësira për ruajtje të publikimeve shkencore që vijnë nga stafi pjesëmarrës në konferenca për qëllim të përdorimit të brendshëm.</li> <li>-Krijimi i një dhome të serverëve për ruajtje dhe simulime</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Numri prezantuesve dhe pjesëmarrësve në seminar</li> <li>-Numri i punimeve të publikuar në edicionin special të ndonjë reviste të caktuar</li> <li>-Numri i konferencave të organizuara, numri i prezantuesve dhe i pjesëmarrësve</li> <li>-Numri i projekteve shkencore të aplikuara/fituara</li> <li>-Përfitimet materiale (financiare dhe laboratorike) të FIM-it</li> </ul>			
	Ngritja e integritetit akademik gjatë	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Krijimi i dispozitave ligjore të nevojshme;</li> <li>-Përditësimi i vazhdueshëm i</li> </ul>	-Numri i rasteve te paraqitura/trajtua	Janar 2023 - Dhjetor 2025	-Prodekani për cilësi dhe	5,000€

	punës kërkimore/shkencore	informatave në ballinën e ueb faqes së FIM-it për mundësitë e financimit kërkimore/shkencore -Trajnimi i stafit për aplikime në grante kërkimore - Implementimi i softuerit antiplagjiature	ra nga komisioni i etikes ne UP -Numri i postimeve te bëra ne ueb faqen e FIM-it për mundësitë e financimit -Numri i pjesëmarrjeve ne trajnime		bashkëpunim me ekonomi -Zyrtari i TI-se	
Inovacioni gjatë punës kërkimore/shkencore	Përkrahja e inovacioneve dhe mbrojtja e pronës intelektuale të UP-së	-Hartimi i bazës ligjore për inovacionet -Harmonizimi i rregulloreve të brendshme të FIM-it me Ligjin për Pronësinë Intelektuale të Republikës së Kosovës - Avancimi i Qendrës se Inovacionit të UP-së, e menaxhuar nga FIM.	-Rregullorja për inovacionet në UP -Futja e deklaratës etike për pronësinë intelektuale dhe inovacionin -Pjesëmarrje ne hartimin e rregullores për pronësinë intelektuale të UP së -Krijimi i Start Up në kuadër të Qendrës se Inovacionit të UP	Janar-2023	-Këshilli i FIM-it - Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim me ekonomi -Shefat e departamenteve	10,000€

### 6.3 Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi

Objektivat strategjike:

- (a) Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies me qëllim të zhvillimit të kompetencave të studentëve
- (b) Cilësia e raporteve të vetëvlerësimit
- (c) Sistemi i matjes së rezultateve të studentëve
- (d) Krijimi i bursave për periudha të shkurta për realizimin e vizitave hulumtuese jashtë vendit

- (e) Programet e doktoratave në FIM në pajtim me sistemin e Bolonjës  
 (f) Ngritja e cilësisë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe aktivitete hulumtuese në FIM  
 (g) Zgjerimi i marrëdhënieve të FIM-it me tregun e punës dhe shoqërinë civile  
 (h) Përfshirja e studentëve në përmirësimin e cilësisë;  
 (i) Rritja e performancës së cilësisë.

Objektivi strategjik	Qëllimi	Detyrat dhe aktivitetet	Indikatorët	Afati kohor	Stafi përgjegjës	Burimet/ kostoja (€)
Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies me qëllim të zhvillimit të kompetencave të studentëve	Përditësimi dhe harmonizimi i programeve të studimit (në përputhje me Deklaratën e Bolonjës dhe zonën Evropiane të arsimit të lartë)	-Zhvillimi dhe implementimi i protokolleve për partneritet me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. -Hartimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare. - Mbjajtja e takimeve të bordit industrial	-Numri i partneriteteve me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim me ekonomi.	
		-Analizimi i informatave të marra nga bashkëpunëtorët, tregu i punës, të diplomuarit, etj. -Zhvillimi i metodave të mësimdhënies, të cilat rrisin pjesëmarrjen aktive (studentëve); -Zhvillimi dhe akreditimi i programeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës.	-Kontakti me institucionet vendore dhe ndërkombëtare; -Hartimi i programeve të reja të studimit ; -Numri i programeve të reja të akredituara . -Numri i programeve ndërdisiplinore në bashkëpunim me universitetet partnere ndërkombëtare.	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	-FIM Departamentet, -Komisioni i studimeve, -Këshilli i Fakultetit	
	Mbështetja e të mësuarit të bazuar në hulumtim	-Zhvillimi i metodave më të mira për mësimnxënie të bazuar në hulumtime për të gjitha nivelet e programeve	-Rritja e interesimit për tu regjistruar në programet studimore dhe	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	FIM/ Departamentet, Komisioni i studimeve,	



		të studimit para akreditimit dhe gjate implementimit. -Përcaktimi i qartë i rezultateve të mësimnxënies në syllabuse për secilin program studimi	rritja e pjesëmarrjes aktive ne ligjërata		Këshilli i Fakultetit	
		-Mundësi më të mira për mësimnxënie të bazuara në hulumtime ( shtimi i komponentës së hulumtimit shkencorë) -Mbështetje e studentëve për pjesëmarrje në konferenca dhe punëtori shkencore	-Numri i konferencave, punëtorive shkencore ku pjesëmarrës janë stafi akademik dhe studentët	Janar 2023- proces i vazhdueshëm	FIM/ Departamentet, Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim me ekonomi	
		-Zbatimi i metodave të mësimdhënies të cilat rrisin pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe kreativitetin gjatë mësimdhënies -Rritja e ndërgjegjësimit për praktikën dhe shkathtësitë më të mira të të mësuarit (duke përfshirë të mësuarit e bazuar në hulumtim dhe të e-mësimit).	- Numri i ngjarjeve të organizuara me qëllim të mësuarit e bazuar në hulumtim dhe të e-mësimit - Materialet e publikuara në ueb faqe të UP-së.	Janar 2023- proces i vazhdueshëm	FIM, Prodekani për mësim, Komisioni i studimeve.	
		-Mbështetje studentëve që të marrin përgjegjësi dhe të përfshihen në asistim në mësimdhënie (studentët e PhD, studentët demonstratorë).	-Numri i studentëve dhe lëndëve të përfshira në mësimnxënie;	Janar 2023- proces i vazhdueshëm	-FIM, -Këshilli i FIM-it	
	Përmirësimi i mjediseve fizike dhe virtuale për studentët e FIM	-Zhvillimi dhe përmirësimi i mjedisit fizik dhe pajisjeve virtuale për mësim në distancë në FIM	-Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së sallave mësimore në FIM	Janar 2023- proces i vazhdueshëm	UP/FIM	

		-Ofrimi i shërbimeve bibliotekare dhe qasje në burime elektronike	-Numri i studentëve aktiv me qasje në këto burime elektronike	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	UP/FIM	
	Inkurajim për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve për stafin mësimdhënës.	-Rritja e bashkëpunimit të fakulteteve dhe departamenteve të tyre me QZHK-ZZHC të UP-së. -Organizimi i trajnimeve adekuate për zhvillim të stafit mësimdhënës për hulumtime	-Numri i publikimeve shkencore të realizuara nga stafi akademik	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	UP/FIM	
	Krijimi i një partneriteti të fortë ndërmjet stafit akademik dhe studentëve.	-Mbështetja dhe promovimi i studentëve me rezultate maksimale brenda FIM-it -Përfshirja e studentëve në dialog me stafin për çështjet që kanë të bëjnë me cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. -Kërkesat e mundshme të studentëve me qëllim të hartimit të lëndëve dhe programeve të përshtatshme. - Identifikimi dhe mbështetja e studentëve më të mirë për të studiuar në UP (fituesit, etj.); -Analiza e shkallës së diplomimit dhe ngeljes/ kalimit të studentëve për module /programe/ fakultete.	- Numri i ngjarjeve të organizuara dhe studentëve pjesëmarrës.	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	-Menaxhmenti i FIM-it - Stafi i FIM-it	Zero
Cilësia e raporteve të vetëvlerësimit	Zhvillimi i mekanizmave të monitorimit dhe Implementimi i cilësisë së raporteve të vetëvlerësimit.	-Zhvillimi e mekanizmave për marrjen e reagimeve nga studentët dhe punëdhënësit (anketa, alumni etj.).	Numri i anketave të realizuara	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	-Menaxhmenti i FIM-it - Stafi i FIM-it -ZZHA	

		-Anketimi me studentë (përmes veglave online), punëdhënësit dhe të diplomuarit (alumni), në mënyrë që të merren reagime në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në FIM.			-TI e FIM-it	
Sistemi i matjes së rezultateve të studentëve	Hartimi i rezultateve të pritura për të gjitha lëndët dhe programet. Implementimi i sistemit të matjes së rezultateve të studentëve. Vlerësimi i studentëve për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.	-Përpunimi i rezultateve të pritura për të gjitha lëndët dhe programet e studimit -Publikimi i rezultateve të vlerësimit -Rishikimi i strategjive për vlerësimin e të nxëniet të studentët; -Zhvillimi i metodologjisë për vlerësim të studentëve; -Zhvillimi dhe implementimi sipas sistemit të Bolonjës dhe syllabusit/ programit të akredituar;	-	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	-Menaxhmenti i FIM-it - Stafi i FIM-it -ZZHA -TI e FIM-it	
Krijimi i bursave për periudha të shkurta për realizimin e vizitave hulumtuese jashtë vendit	Rritja e numrit të mundësive për stafin dhe studentët e FIM për të realizuar vizita hulumtuese, krijuar rrjete globale dhe për të rritur produktivitetin e tyre.	-Inkurajimi dhe mbështetja e vizitave hulumtuese afatshkurta për stafin dhe studentët e FIM. -Promovimi i fondeve mbështetëse për mobilitete	-Financat e ndara dhe shfrytëzuara çdo vit për këtë aktivitet;	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	UP/FIM	3.000
Programet e doktoratave në FIM në pajtim me sistemin e Bolonjës	Zhvillimin e programeve të studimeve të doktoratës për fushat e studimit në FIM	-Mbështetje për programe të studimeve PhD që do të zhvillohen në disiplina të ndryshme, si dhe aplikimi për akreditim të këtyre programeve	-Numri i programeve të akredituara -Numri i studentëve të regjistruar	Janar 2024-proces i vazhdueshëm	-Menaxhmenti i FIM-it - Stafi i FIM-it	

Zgjerimi i marrëdhënieve të FIM-it me tregun e punës dhe shoqërinë civile dhe ngritja e cilësisë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe aktivitete hulumtuese në FIM	Inkurajimi i përfshirjes së kapaciteteve kombëtare dhe ndërkombëtare në kërkime shkencore dhe aktivitete zhvillimore.	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Identifikimi i kontakteve dhe hulumtuesve ndërkombëtarë dhe kombëtarë;</li> <li>-Krijimi i bazës së të dhënave të kontakteve të hulumtuesve nga diaspora;</li> <li>-Vendosja e kontakteve dhe përkrahja e hulumtuesve nga diaspora.</li> <li>-Përcaktimi i detyrimeve kontraktuale për veprimtari kërkimore shkencore për stafin akademik.</li> <li>-Krijimi i bazës ligjore dhe rregulloreve për angazhimin e stafit të FIM-it duke u bazuar në praktikat më të mira evropiane.</li> <li>-Ofrimi i së paku një kursi në secilin program të studimit të nivelit bachelor dhe master në Gjuhën Angleze</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Numri i stafit ndërkombëtarë hulumtues të angazhuar</li> <li>-Numri i kurseve të ofruara në Gjuhën Angleze</li> <li>-Numri i studentëve të përfshirë në kurset e ofruara në Gjuhën Angleze</li> </ul>	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	FIM	12,000
	Krijimi i partneriteteve strategjike me institucionet me reputacion ndërkombëtar.	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Krijimi i bazës ligjore për bashkëpunime</li> <li>-Rekomandimet e Grupit Konsultues për veprimtari kërkimore shkencore të FIM-it për 2-3 partnerët strategjikë të fakultetit.</li> <li>-Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me partnerë strategjik të FIM-it</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Numri i partneriteteve të realizuara</li> </ul>	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	FIM	

	Shpërndarja/ publikimi i informatave rreth mundësive për bashkëpunim. Mbështetja e përvetësimit të granteve nga agjencitë kombëtare të financimit dhe institucionet private apo publike.	-Informata relevante lidhur me mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar. -Krijimi i dispozitave ligjore të nevojshme; -Themelimi i fondacionit të UP-së		Janar 2023-proces i vazhdueshëm	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim me ekonomi	
	Hartimi dhe zbatimi i planeve 3-vjeçare për aktivitete kërkimore shkencore në FIM	Krijimi i një grupi punues për dizajnimin e planit zhvillimor 3-vjeçar. Miratimi i zhvillimit të planit 3 vjeçar.	-Rezultatet e realizimit të këtij plani	2025	Prodekani për cilësi dhe bashkëpunim me ekonomi	
	Promovimi i kompetencave akademike dhe profesionale për programet e studimit në FIM Përgjigje në mësimdhënie dhe hulumtim për nevojat më të gjera të shoqërisë.	-Promovimi i kompetencave akademike dhe profesionale për të gjithë të diplomuarit që synojnë punësim në sektorin publik dhe në jetën publike -Promovimi i kompetencave të përgjithshme për të gjithë të diplomuarit që synojnë punësim, sidomos në fushën e arsimit të përgjithshëm dhe profesional, sistemit juridik, mjekësi, inxhinieri aplikative, administratë publike etj. - Komunikimi me shkollat e mesme, në mënyrë që të sigurojë informacione dhe orientim për nxënësit e shkollave të mesme dhe për	-Zhvillimi dhe implementimi i kompetencave akademike dhe profesionale  -Zhvillimi i projekteve kërkimore të cilat i përgjigjen nevojave të gjera të shoqërisë  -Zhvillimi i marrëdhënieve me shkollat e mesme;  -Organizimi i vizitave/sesioneve informuese, etj -Zhvillimi dhe implementimi i kompetencave akademike dhe profesionale.	Janar 2023-proces i vazhdueshëm	UP/ FIM  FIM  FIM  FIM	

